

Data 16.07.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Investime pilot për transformimin e infrastrukturës së shërbimeve dhe rritjes së standardit të jetës në komunitet: “Përshtatje e mjediseve për akomodimin e “Njësisë së Sigurisë Publike Shkodër”.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 19,690,326.47 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA , me kod projekti 24AC001 .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **financiare 2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e marrëveshjes kuadër në procedurën e prokurimit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”b”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: ”b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të

mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anetari i cili ka perqidjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me perqidjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.

Per te vertetuar pervojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vertetime të leshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, duhet të paraqiten vertetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontraten/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi

Shënim: OE/BOE, për punët e ngjashme të realizuara që shtrihen pjesërisht brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës provues që vërteton qartë pjesën e punimeve të realizuara brenda kësaj periudhe, si dhe vlerën monetare të punimeve të ekzekutuara gjatë saj.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontrates, eshte mbi kufirin e ulet monetar. Vlera per pune te ngjashme perben nje nivel te mjaftueshem pervojave duke patur parashysh objektin dhe vleren e kontrates.

Pervoja e meparshme eshte element shume i nevojshem qe garanton autoritetin, se operatorët ekonomike mbi bazen e vleres se puneve te ngjashme zoterojne kapacitete per te zbatuar kontraten me sukses sipas nje standarti te pershtatshem cilesie. Ne mbështetje te nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operatorësh ekonomike, sipas percaktimit te pikave 2 dhe 3, te nenit 14, te LPP-se, ku njeri prej te cileve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe, ne rast perzgjedhjeje, edhe gjate zbatimit te kontrates. Ne oferte duhet te percaktohet pjesa e sherbimit, punes ose furnizimit, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi nepermjet nje kontrate bashkepunimi te hartuar ndermjet paleve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese licencen profesionale - te shoqerise, te vlefshme per zbatimin e punimeve objekt kontrate, leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve. Licenca duhet te permbajë kategoritë e punimeve të kontratës si me poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

N.P -	1.	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P -	2.	A	Ndertime civile dhe industriale
N.P -	3	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
N.P -	7.	A	Ujësjiellës, Gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje
N.P -	11.	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
N.P -	12.	A	Punime te inxhinierise se mjedisit.

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

N.S -	1.	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S -	2.	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirembajtja e tyre
N.S -	4.	A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.
N.S -	8.	A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
N.S -	12.	A	Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit.
N.S -	14.	A	Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
N.S -	18.	A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008).

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per -prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", i ndryshuar. Te dhenat per licencat e mesiperme jane vendosur referuar bases ligjore per ndertimet, ligjit nr. 8402 date 10.9.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" te ndryshuar, neni 8 percakton "Zbatimi i punimeve te ndertimit kryhet vetem nga persona juridike, private ose publike, vendas ose te huaj, te pajisur me licencen perkatese, per zbatim punimesh ndertimore. Zbatuesi i punimeve mban pergjegjesi dhe eshte i detyruar te realizoje punimet e ndertimit, ne perputhje me lejen e ndertimit, projektin, kushtet teknike te zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te siguroje cilesine e materialeve te ndertimit dhe produkteve te ndertimit, te cilat duhet te plotesojne kerkesat e projektit ne perputhje me standartet kombetare ose europiane.

Kategorite jane kerkuar bazuar ne zerat dhe vlerat e punimeve, si me poshte:

Kategoria e kerkuar	Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes	Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese	Niveli i klasifikimit i kerkuar per kategorine respektive	Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese
N.P-1. A	Punime germimi ne toke.	- Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e forte.	0-20 mln leke	697,916 leke
N.P- 2 A	Ndertime civile dhe industriale.	- Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa - Mur me tulla me 4 vrima, t=10cm h~3m, LL.P. M-15 - F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm - Mur betoni C 16/20 - Beton C-25/30 (Me cakell)	0-20 mln leke	4,195,707 leke
N.P -3. A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash, civile, dhe industrial, veshje fasada	- Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri - Shtrese me pllaka porcelanat - Torkretim me llac cemento 1: 2, t = 3 cm	0-20 mln leke	1,124,760 leke
N.P -7. A	Ujesjellësa, Gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje	- F.V. Tub xingato dhe rakorderi ~ 1 " - F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm - F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50 - F.V. Tuba plastmasi dhe rakorderi - F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn	0-20 mln leke	1,401,163 leke

		16 - F.V. Tuba e rakorderi PVC - F.V. Tuba PVC Ø 250 mm per linja te jashtme - F.V. Tuba çeliku i zi - F.V. Hidrante Ø 50 mm - F.V. WC allafrenga - F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte - F.V. Lavamane porcelani - F.V. Kolektor shpendares 3/4" (4+4)		
N.P -11. A	Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	- F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 - F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm2 - F.V. Percjelles PPV Ø 2x1.5 mm2 - F.V. Kuti suport pllaket 2 mod - F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A - F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m - F.V. Ndricues fluoreshent 2x36w,IP40 - F.V. Ndricues projektor me llampe SAP-T 250w - F.V. Ndricues tip plafoniere ,me llampe fluoreshente 40w, - F.V. Ndricues fluoreshent 2x40w,IP40 - F.V. Kabell FG16OM16-0,6/1 kV, S=5x2.5 mm2 - F.V. Kabell FG16OM16-0,6/1 kV, S=3x2.5 mm2 - F.V. Kabell FG16OM16-0,6/1 kV, S=3x1.5 mm2	0-20 leke mln	1,406,411 leke
N.P -12. A	Punime te inxhinierise se mjedisit	- Referuar Relacionit Teknik dhe projektit te zbatimit	0-20 leke mln	0.00 leke
N.S-1. A	Punime për prishjen e ndërtimeve	- Heqje pllaka dysHEMEJE - Heqje bazamake shkallësh - Heqje pllakash majolike - Prishje shtrese lluster-çimento dysHEMEJE - Prishje shtresa betoni - Prishja e rjetit ekzistues elektrike - Prishja e rjetit ekzistues hidraulik	0-20 leke mln	442,185 leke
N.S-2. A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina,lavan deri, mirembajtja e tyre	- F.v Fikese zjarri me shkume - F.V Butona maual te lajmerimit te zjarrit	0-20 leke mln	246,930 leke
N.S-4. A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale	- Boje hidroplastike cilesi e larte - Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm - Patinim muri me stuko - Suvatim me llaç-çimento - F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. - Dyer te blinduara - F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham	0-20 leke mln	4,410,264 leke

		- Shtrese parketi - Mbulim çatie me panele sanduich		
N.S– 8. A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	- F.V. Konstrukione metalike te perbera - Konstrukione metalike te thjeshta	0-20 leke	mln 729,994 leke
N.S–12. A	Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit.	- Mirembajtje e sistemit te kondicionimit	0-20 leke	mln 434,948 leke
N.S–14. A	Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	- F.V. Central zjarri I adresueshem, me mundesi komunikimi ne rrjet centralesh nepermjet kartave , LCD panel, Karte Loop, Karte RL etj. - F.V Detektor tymi - F.V Drejtim i daljes se emergjences - F.V Kanaline plastike 90/60mm me aksesore - F.V. Prize " Schuco " 16A, te bardhe - F.V. Prize " Schuco " 16A, te kuqe - F.V. Kuti, suport , kapak & tapa 4 moduleshe - F.V. Kuti shperndarese b/m. dim. 198*152*70 mm - F.V. Celes 1 polar, 1 modular, 10A, 250V - F.V. Kuti, suport , kapak & tapa 3 moduleshe - F.V. Kuti, suport , kapak & tapa 3 moduleshe - F.V. Priza rrjeti tip RJ-45, cat 6e, FTP - F.V. Kabllo rrjeti kompjuterik, Tip FTP-cat6 LSZH - F.V. Priza rrjeti kompjuterik, - F.V. Fiber optike 12 kopje, singel mode - F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares i forte Ø 20 mm - F.V. Kabell me izolim PVC, S=2x1 mm², FTG40HM1 - F.V. Set 8 shuko per rack - V. Switch me 24 porta RJ-45, FTP cat 6e - F.V. Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6e - V. F. U.P.S. 10 KVA, tension 3 fazor hyrje dhe 3 fazor dalje , dopio konvertim online, 15 min auotonomi, me te gjitha lidhjet e nevojshme fleksibel dhe cdo komponent tjeter qe kerkohet pe instalimin dhe komisionimin. Perfshire automatin e baterive ne panel, Kballot DC dhe cdo aksesor tjeter per ins - F.v Sirene Lajmeruese - F.v Kuadri QO RRJET - F.V Kuadri Q1 UPS	0-20 leke	mln 3,096,120 leke
N.S -18. A	Punime topogjeodezike	- Referuar Relacionit Teknik dhe projektit te zbatimit	0-20 leke	mln 0 leke

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarres, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) inxhinier Elektrik
- 1 (nje) inxhinier Gjeodet

Per te deshmuar permbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punes

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

ARGUMENTIMI I STAFIT

Punimet apo veprimtarite konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

Inxhinier Ndërtimi	Inxhinieri i ndërtimit nevojitet për organizimin e kantierit të ndërtimit, për ndjekjen në tërësi të punimeve dhe bën koordinim të të gjithë personelit teknik në objekt për mbarëvajtjen e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe grafikut të parashikuar në kontratë. (Referuar zërave të punimeve të preventivit)
Inxhinier Hidroteknik	Inxhinieri hidroteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve të furnizimit me ujë e kullimit të ujërave (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Gjeodet	Inxhinieri gjeodet nevojitet për piktetimin fillestar të objektit dhe piktetimin në vazhdimësi të të gjithë punimeve sipas proceseve të punës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mekanik	Inxhinieri mekanik nevojitet për ndjekjen e punimeve të sinjalistikës dhe Strukturave metalike (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mjedisi	Inxhinieri gjeodet nevojitet për organizimin e prishjeve të ndryshme, transportin e mbeturinave deri në sistemin në impiantin e mbetjeve.

	(Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Elektrik	Inxhinieri elektrik nevojitet për Instalimet e ndricimit, impjante të brendshme elektrike, telefoni, sistem telekamera

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate duhet te disponoje fuqi punetore prej minimalisht 20 persona, numri i punonjesve duhet te disponohet per secilin muaj, per periudhen 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim te leshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

ARGUMENTIMI NR PUNONJESVE

Ne percaktimin e numrit te punonjesve specialisti i fushes ka bere nje analize bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategorite e punimeve, kualifikimi i punonjesve, grafiku i punimeve, zerat e punimeve dhe oret e punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjesve dhe qendrueshmeria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 mujore nga momenti i hapjes, tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbush kontraten. Deshmia e kerkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit e parashikuar nga Kadi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrueshmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operatoreve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiences qe duhet te kete kjo kategori e punonjesve. Vendosja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumen e punes, natyren dhe terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka rie funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 216, date 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim" Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punetore ze rreth 25% te kostos.

Total ore pune = 10,788.01 (referuar zerave sipas grafikut te punimeve)

Ore/1 dite pune = 8 ore

Total dite pune = 10,788.01 ore/8 ore= 1,348.50 dite pune

Dite pune gjithesej= 3 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 dite/muaj= 66 dite pune

Numri i fuqise puntore = 1,348.50 dite/66 dite = 20.43 punonjes (punetor)

Ne menyre te permbledhur numri i fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshte min **20 punonjes**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje, mjetet dhe pajisjet e meposhtme ne pronesi ose qira ose kontrate furnizimi.

Nr	Lloji i makinerive	Njësia	Sasia	Statusi
1	Kamionçinë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamion me vinç	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Autobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Autopompë betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Kompresor	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Gjenerator	Copë	1	Në pronësi ose me qira

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara ne asnje kontrate tjeter publike, qe bie ndesh me legjislacionin e fushes se ndertimit, dhe do te angazhohet vetem per realizimin e ketij objekti.

Si deshmi per te vertetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do te paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose te kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshtetese

per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

ARGUMENTIMI MJETET

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, jane hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit te fushes bazuar ne VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018).

Nr	Lloji i makinerive	Argumentimi
1	Kamionçinë	- Transport materialesh: ndertimi, hidraulike, elektrike etj
2	Kamion me vinç	- F.V. Konstruksione metalike te perbera - Konstruksione metalike te thjeshta
3	Autobetoniere	- Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri
4	Autopompë betoni	- Mur betoni C 16/20 - Beton C-25/30 (Me cakell)
5	Kompresor	- Referuar Relacionit Teknik dhe projektit te zbatimit
6	Gjenerator	

2.3.7 Kerkesa te tjera te vecanta per kualifikim

Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit te cilesise) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe te leshuara nga organizma te vleresimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise.

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper; ose ti kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbështetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

Shënim:

Mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera

Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë **nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera** për kriteret që lidhen drejtpërdrejtë me realizimin e proceseve kryesore të kontratës, konkretisht:

- përvojën e mëparshme të ngjashme;
- personelin/stafin kryesor;
- bilancet vjetore;
- licencat profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Këto kapacitete konsiderohen thelbësore për realizimin e kontratës, pasi lidhen drejtpërdrejt me organizimin e punimeve, koordinimin e zbatimit në kantier, përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë gjatë realizimit të punimeve objekt kontrate. Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto kriteret mund të cenojë realizimin efektiv dhe të besueshëm të kontratës. Për këtë arsye, këto kapacitete duhet të disponohen dhe të angazhohen drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ose anëtar i përkatës i BOE që do të realizojë punimet, me qëllim garantimin e përgjegjshmërisë, cilësisë së ekzekutimit dhe minimizimin e riskut gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Për vet natyrën e vecante, vendndodhjes dhe permasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që cdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtesisht me objektin e kontratës përse koha do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatoreve ekonomike dhe të mundësive të tyre për përmbushjen e plate të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Projekti zbatimit, Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe janë pjesë e DST.

Ne çdo rast nëse janë përmendur marke prodhimi ose proces i vecante në dokumentet e tenderit në këto procedurë prokurimi do të pranohen edhe ekuivalent.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | | |
|---|-------|----|
| 1. Çmimi | pikët | 75 |
| 2. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) | pikët | 10 |
| 3. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët | 10 |
| 4. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët | 5 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 75] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$	
P_{k3}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k3}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k3}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k3}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

3. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$	
P_{k4}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k4}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k4}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k4}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do të ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

4. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubriken specifike/zerin “Siguria në kantier (Plani I Sigurisë e Kordinimit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023)”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posacme edhe me përmbyshjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbyshen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrikë në masën jo më pak se 3%, përllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast **jo më pak se 537,723.61 leke pa tvsh**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbyshja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 537,723.61 leke pa tvsh.**

- Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 537,723.61 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)
- Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 537,723.61 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet
 $V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
 $P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
 O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)
 Mo – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme
 N – Numri i ofertave të vlefshme
 $PR (R_{rm})$ – Krijtje e mundshme
 $Mo = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$
 $PR = 200 \% Mo$

Vlera e ofertave të ofruara > PR rjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar

permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.